

Udhëzime të Ministrisë së Tregëtisë
N. Rep. 1627 Kol. 116

PROCES VERBAL
I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE ASAMBLESE SE SHOQERISE ME
PERGJEGJESI TE KUFIZUAR KAVAJA AGRICULTURAL PRODUCTIONS ME
INICIALE K.A.P. SHPK
ME QENDER NE KAVAJE



Sot, me dt. 28.06.2002, ora 10:00, prane selise ligjore ne lagjen nr. 3, Kavaje, ne pranine time noteres Gjyltere Pustina, anetare e dhomes se noterise Tirane, jane mbledhur ortaket qe perfaqesojne te gjithë kapitalin e shoqerise K.A.P. shpk per te diskutuar e vendosur mbi rendin e dites si vijon :

- 1- Shqyrtimi dhe vendimi I ortakeve mbi propozimin e bere nga Presidenti I Asamblese se shqerise K.A.P. shpk, per rritjen e kapitalit te shoqerise K.A.P. shpk nga 108 411 810 ne 152 248 115 leke sipas kerkesave qe parashikon Ligji no. 7638 date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare si dhe te statutit te shoqerise K.A.P shpk.,
- 2- Te ndryshme dhe eventuale.

Jane te pranishem z. Marcello Alloisi, Administrator I shoqerise K.A.P. shpk, (shtetas italian, lindur ne Itali, Lecce, dhe banues ne Tirana, Rr. Bul. Zogu I, nr. 31) me pasaporte nr. Y 028532) z. Florion Tefiku, perfaqesues I pales italiane dhe perkatesisht I shoqerise T.U.R.I.S.M.A shpk, dhe z. Kujtim Katroshi, (shtetas shqiptar, I biri I Namir, lindur ne Kavaje, dt. 12.10.1954, banues ne Kavaje, me pasaporte nr. 302866) perfaqesues I ortakut shtet ne shoqerine K. A.P. shpk. Kryeson asamblene z. Marcello Alloisi dhe emerone sekretar z. Kujtim Katroshi, qe pranon. Kryesuesi I asamblese pasi verifikon vlefshmerine e mbledhjes e deklarone ate te hapur dhe pasi lexon rendin e dites pyet nese ka ndonjekundershtim lidhur me te. Meqe nuk ka kundershime ne parim, atehere Presidenti I asamblese se shoqerise K.A.P. shpk propozon te kalohet ne diskutimin e pikes se pare te rendit te dites. Ne lidhje me piken I te rendit te dites e merr fjalen I pari perfaqesuesi I pales italiane, d.m.th I shoqerise italiane T.U.R.I.S.M.A shpk, qe eshte dhe ortak ne shoqerine K.A.P. shpk me 75 % te kuotave ne kapitalin themeltar te saj I cili ne diskutimin e tij deklarone se eshte plotesisht dakort per miratimin e pikes I te rendit te dites, d.m.th per 152 248 115 leke, pra rritjen e tij me nje vlere prej 43 836 305 leke (dyzet e tre milione e teteqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pese leke). Gjithnje ne vijim te diskutimit te pikes I te rendit te dites, e merr fjalen z. Kujtim Katroshi, I cili, qe meqe nuk ka pasur asnje prononcim nga eproret e tij te Ministrise se Ekonomise ne periudhen kohore gjate dy mbledhjeve te asamblese se ortakeve te K.A.P. shpk (nga dt. 28.05.2002 deri me dt. 28.06.2002) per qendrimin qe duhet te mbaje pala shqiptare ne kete mbledhje te jashtezakonshme te shoqerise K.A.P. shpk per rritjen e kapitalit te shoqerise per sa me siper, edhe pse jane lajmeruar me leter rekomande prej tij, (e cila dhe eshte protokolluar nga Ministria) deklarone se nuk mund te prononcohet per piken I te rendit te dites, duke preferuar te abstenoje. Ne keto kushte, e merr perseri fjalen perfaqesuesi I pales italiane, z. Florion Tefiku, (shtetas shqiptar, I biri I Mirgjinit, I dt. 09.02.1969 dhe banues ne Tirane, Rr. Hoxha Tahsim, nr. 52, me pasaporte nr. 075037 sipas prokures se posacme me rep nr. 4200 redaktuar nga noteri italian doktor Carmelo Messina) I cili pasi degjon deklarimin e z. Kujtim Katroshi, I ben te ditur te pranishmeve qe ai eshte I vendosur

H. M.

Katroshi

Tefiku

143

te miratoje rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise tregtare K.A.P. shpk me nje vlere prej 43 836 305 leke pavaresisht nga abstenimi I perfaqesuesit te pales shtet ne shoqeri, pasi ai zoteron 3/4 e kapitalit themeltar te shoqerise K.A.P. shpk dhe ligjerisht mund te ndermarre nje vendim te tille edhe pse ortaku tjetër me 25% te kapitalit abstenon. Kete rritje te kapitalit ai e konsideron ekstremisht te nevojshme per ekzistencen e shoqerise ne te ardhmen pasi aktualisht shoqeria rezulton me nje kapital themelat negativ duke mos pasur kredibilitetin e duhur ne tragun kombetar dhe ate nderkombetar, si dhe ne mos perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi per funksionimin e shoqerive tregtare.

Gjithashtu perfaqesuesi I pales italiane, gjate diskutimit te tij deklaroi se me rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise K.A.P. shpk ne vleren prej 43 836 305 leke do te mbuloje edhe ate pjese te kuotave qe mbeten te pa mbuluara nga ortaku shtet. Ne keto kushte per realizimin e sa me siper, ai propozon Artan Golemi, shtetas shqiptar, I biri I Astritit, lindur ne Tirane, dt. 13.12.1957, dhe banues ne Tirane, Rr. Asim Vokshi, pll. 91/1, ap.11, ne cilesine e Ekspertit-Kontabel, me license profesionale nr. 80 leshuar me dt. 17.04.2000, te procedoje per perpilimin dhe redaktimin perfundimtar te aktit te ekspertizes mbi zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise K.A.P. shpk ne vleren prej 43 836 305 leke, vlere e cila perbehet si nga mjete monetare ashtu dhe ne natyre. Per kete ai ngarkon administratorin e shoqerise K.A.P. shpk z. Marcello Alloisi te procedoje ligjerisht ai vete ose persona te tjere te ngarkuar prej tij per ndjekjen dhe permbushjen e te gjithe praktikes ligjore prane Zyres se Regjistrimit tregtar te Gjykates se Shkalles se pare Tirane per emerimin e Ekspertit Kontabel te propozuar lart z. Artan Golemi.

Nga ana e tij Administratori I shoqerise K.A.P. shpk merr persiper te ndjeko praktiken ligjore per emerimin e ekspertit kontabel si me siper. Pas kesaj Presidenti I Asamblese propozon te mbahet nje mbledhje tjetër e Asamblese se ortakeve te K.A.P. shpk prane selise se saj ligjore ne Kavaje, me dt. 18/09/2002 ore 10:00 per te diskutuar mbi rendin e dites vijues :

1. Shqyrtimi I aktit te ekspertizes prezantuar nga Eksperti Kontabel z. Artan Golemi, mbi zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise K.A.P. shpk ne vleren prej 43 836 305 leke.
2. Te ndryshme dhe eventuale.

Duke mos pasur asnje argument tjetër per te diskutuar dhe persa asnjëri nuk kerkon fjalen, Presidenti I Asamblese se ortakeve te shoqerise K.A.P. shpk deklaroi mbylljen e punimeve te mbledhjes rreth ores 13 : 00.

Une noteri vertetoi rregullshmerine e sa me siper, dhe firmat e te pranishmeve si vijon :

Per palen italiane
z. Florion Tefiku
Administratori I shoqerise
z. Marcello Alloisi

Per palen shqiptare
z. Kujtim Katroschi

Ky akt u perpilua ne kater kopje origjinale, ne dy faqe dy flete.

Notere
Gjykatere Përmirë
Dimitris 166

Dhoma e Noterise Tirane
Nr. 2425 Rep. Nr 168 kol.

PULLE TAKSE




PROCES - VERBAL

I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KAVAJA ACQUACULTURE PRODUCTIONS" ME INICIALE "K.A.P." shpk ME QENDER NE KAVAJE

Sot, me date 18.09.2002, ora 10:00, prane selise se saj ligjore ne Kavaje, Lagjia 3, ne pranine time notere Gjyltere Pustina, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, jane mbledhur ortaket qe perfaqesojne te gjitha kapitalin e shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk per te diskutuar dhe vendosur mbi rendin e dites si vijon :

- 1- Shqyrtimi i Aktit te Ekspertizes/ Raportit te Vleresimit, prezantuar nga Eksperti Kontabel z. Artan Golemi mbi zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise K.A.P. shpk ne vleren prej 44750941 leke. (dyzetelbete milionecolltoke indoprodhjet e rijs e portofid e shpke e rijs leke)
- 2- Te ndryshme dhe eventuale.



fushine

Jane te pranishem z, Marcello Aloisi, Administrator i shoqerise "K.A.P." shpk (shtetas italian, lindur ne Itali, Lecce dhe banues ne Tirane, Rr. Bul. Zogu i Pare, nr.31, me pasaporte nr. Y 028532), z. Francesco Roggia, lindur ne Foggia, Itali, i dt. 02.03.1982, dhe banues ne Itali, Rr. Calabria, 6, Orta Nova, Foggi, ne cilesine e Administrator i Vetem i shoqerise T.U.R.I.S.M.A. shpk me seli ne Lecco, Itali dhe Perfaqesues i pales italiane ne kete mbledhje te asamblese, si dhe z. Kujtim Katroshi, (shtetas shqiptar, lindur ne kavaje, i dt. 12/10/1954, banues ne Kavaje, mbajtes i pasaportes me nr. 1082917) ne cilesine e Perfaqesuesit te ortakut shqiptar ne shoqerine K.A.P. shpk. Kryeson mbledhjen e Asamblese Administratori Marcello Aloisi dhe emerone sekretar z. Kujtim Katroshi, qe pranon.

Kryesuesi i asamblese se ortakeve pasi verifikon vlefshmerine e mbledhjes e deklarone ate te hapur dhe pasi lexon rendin e dites pyet nese ka ndonje kundershtrim lidhur me te . Meqe nuk ka kundershtrime ne parim, atehere Presidenti i asamblese se ortakeve K.A.P. shpk propozon te kalohet ne diskutimin e pikes se pare te rendit te dites.

M. Aloisi

Katroshi

Francesco Roggia

149

K.A.P. SHPK
HOTEL
TIRANE

Ne lidhje me pikën 1 të rendit të dities e merr fjalën i pari perfaqësuesi i pales italiane, pra Administratori i Vetem i shoqërisë T.U.R.I.S.M.A. shpk z. Francesco Roggia i cili, pasi është njohur me Raportin e Vleresimit të përgatitur nga Eksperti Kontabel Artan Golemi, në thelbin e diskutimit të tij deklaroi se duke gjykuar në përgjegjësinë dhe seriozitetin e ekspertit kontabile se është dakort dhe e pranon Raportin e Vleresimit të përgatitur nga Eksperti dhe për këtë është dakort që të procedohet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë K.A.P shpk.

Gjithnjë në vijim të diskutimit të pikës 1 të rendit të dities e merr fjalën Perfaqësuesi i pales shqiptare, z. Katroshi, i cili, pasi është njohur me Raportin e Vleresimit, deklaroi se dëshiron të abstenojë.

Në këto kushte, e merr fjalën perseri, perfaqësuesi i pales italiane z. Roggia, i cili pasi degjon deklarinimin e z. Katroshi, i bënte ditur të pranishmëve se ai ~~është~~ vendosi te miratojë Raportin e Vleresimit mbi rritjen e kapitalit të shoqërisë K.A.P. shpk, me një vlerë prej 44750941 leke, pavarësisht nga abstenimi i vazhduar i pales shqiptare.

Për këtë ai ngarkoi Administratorin e shoqërisë "K.A.P." shpk z. Marcello Aloisi të procedojë ai vetë ose persona të tjerë për ndjekjen dhe përbushjen e të gjithë praktikës ligjore pranë Zyres së Regjistrimit tregtarë të Gjykatës së shkallës së Parë të Tiranës, për depozitimin e këtij proces – verbalit, Raportit të Vleresimit si dhe dokumenteve të tjerë ligjore që vërtetojnë këtë rritje kapitali.

Nga ana e tij Administratori i shoqërisë K.A.P. shpk merr përsipër dhe pranon të ndjekë praktiken ligjore për depozitimin e sa më sipër.

Duke mos patur asnjë argument tjetër për të diskutuar dhe persë anjeri nuk kërkon fjalën, Presidenti i Asamblesë/Administratori i K.A.P. shpk deklaroi mbylljen e punimeve të mbledhjes rreth orës 11:30

Sekretari

Kujtim Katroshi

Kujtim Katroshi

Ky akt i përpiluar në katër kopje origjinale, në dy faqe, në flete të ndryshme.

Presidenti i Asamblesë

Marcello Aloisi

Marcello Aloisi

Notere
Gjykatë Pustina
[Signature]

Francesco Roggia

150

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1282 REP.
NR. 68 KOL



VENDIM (PROCES - VERBAL) I
ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"KAVAJA ACQUACULTURE PRODUCTIONS"
ME INICIALE "K.A.P." Sh.p.k.,

ME QENDER NE KAVAJE, NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Sot, me date 10/06/2003, (dhjete qershor dy mije e tre) ora 10:00, prane studios sime te noterise me seli ne Tirane, Bul. "B.Curri", Pll. 1 Maji, jane mbledhur ortaket qe perfaqsojne te gjithe kapitalin e shoqerise "Kavaja Acquaculture Production" Sh.p.k. per te diskutuar mbi rendin e dites si vijon :

1. Diskutimi i llogarive te shoqerise per vitin financiar 2002,
2. Diskutimi i propozimit te ortakut shtet perkatesisht Ndermarrja e Rritjes dhe Zenies se Peshkut Kavaje sipas shkreses se ketij te fundit me nr. 3127/1 date 15.05.2003 mbi shperndarjen e rezultatit te ushtrimit 2002,
3. Te tjera dhe eventuale.

Rezultojne te pranishem ortaket qe perfaqesojne te gjithe kapitalin themeltar te shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk, dhe pikerisht z. Marcello Aloisi, shtetas italian, lindur me 08/07/1944 ne Sogliano, Cavour (Lecce) Itali, mbajtes i pasaportes nr. Y 028532, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e Ortakut dhe Administratorit te shoqerise "K.A.P." Sh.p.k, z. Massimo Carnevalli, shtetas italian, lindur ne Rome, i dt. 03/05/1957, banues ne Itali, Rome, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, me pasaporte nr. 524693 T, perfaqesuar nga z. Savino Roggia, shtetas italian, i pajisur me prokure te posacme per perfaqesim me repertor nr. 2164 dhe kol. Nr. 316 redaktuar me date 02/06/2003 nga notere A.Shameti, si dhe "Ndermarrja e Rritjes dhe Zenies se Peshkut Kavaje" perfaqesuar nga z. Kujtim Katroshi, shtetas shqiptar, i biri i Namirit, i dt.1954, lindur e banues ne Kavaje, me pasaporte nr. 302866, i pajisur me dokumentin perkates si perfaqesues i N.R.Z.P. Kavaje.
Ne baze te Statutit kryeson Administratori i shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk z. Marcello Aloisi, i cili propozon per sekretar te mbledhjes z.Kujtim Katroshi. Ky i fundit pranon sa me siper, Presidenti i Asamblese shpall te vlefshme Pas caktimit te funksioneve si me siper,
mbledhjen e asamblese se ortakeve te shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk. Pas kesaj kalohet ne diskutimin e rendit te dites.
1. Lidhur me piken 1 te rendit te dites te pranishmit ne menyre unanime vendosin te :



a) Miratohet Bilanci Kontabel i dates 31.12.2002 i shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk, per gjendjen e llogarive te Aktivit e Pasivit ne shumen e barabarte prej **126 586 851,35 leke** si dhe per rezultatin financiar per vitin ushtrimor 2002, me humbjen prej **3.777.511,50 leke** e analizuar ne pasqyren anekse te Bilancit "Humbje-Fitime" (konto ekonomike).

2. Lidhur me piken 2 te rendit te dites, administratori i shoqerise "K.A.P" shpk paraqet per diskutim shkresen e ortakut shtet (nr.3127/1 date 15.05.2003), nepermjet se ciles i propozohet asamblese se ortakeve te "K.A.P." shpk te miratoje shperndarjen e rezultatit te vitit 2002. Pas diskutimeve lidhur me kete pike, me shumice votash, (mbi 75%) u vendos qe:

a) Te mbulohet plotesisht humbja e rezultuar per veprimtarine ekonomike te vitit 2002, e cila sipas Bilancit Kontabel te dates 31.12.2002 rezulton ne shumen prej **3.777.511,50 leke**.

b) Shuma e humbjes se mesiperme te perballohet krejtesisht nga gjendja e llogarise "Derdhje te ortakeve, e cila sipas Bilancit kontabel te dates 31.12.2002 ka nje teprice kreditore prej **127.496.531 leke**. Pas mbulimit te humbjes se sipërme gjendja e kesaj llogarie mbetet ne **Leke 123.719.019,50 leke**, e cila, sipas vendimit te Asamblese se ortakeve te dates 18.09.2002 dhe Vendimit te Gjykates se Tiranës nr. **6987/6 date 04.11.2002** i perket z. Marcello Aloisi ne masen 55%, z. Massimo Carnevalli ne masen 27,5% si dhe Ndermarrja e Zenies dhe Rritjes se Peshkut ne masen 17,5%.

Me mbulimin e humbjes se vitit 2002 si me siper, **kapitali faktik i Shoqerise mbetet po ai i paraqitur ne Bilancin Kontabel te 31.12.2001, pra ne 1.914.635,85 Leke** (si diference e kapitalit prej 153 162 751, 70 leke pakesuar per mbulimin e humbjeve deri me 31.12.2001, per 151 248 115,85 leke). Perketesia e ketij kapitali mbetet ashtu sic eshte percaktuar me vendimin e siperpermendur te asamblese se shoqerise (date 18.09.2002) dhe vendimit perkates te Gjykates se Tiranës (Nr. 6987 date 04.11.2002) ne kuotat : z. Marcello Aloisi ne masen 55%, z. Massimo Carnevalli ne masen 27,5% si dhe Ndermarrja e Zenies dhe Rritjes se Peshkut ne masen 17,5%.

3. Lidhur me piken 3 "Te tjera dhe eventuale" me shumice votash (mbi 75%) u vendos:

a) Per veprimet si me siper te njoftohet menjehere dhe te behen veprimet perkatese ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Tiranës.

b) Sektori i Finances se Shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk te reflektoje ne kontabilitetin e firmes ndryshimet persa u vendosen si me siper.

Asambleja e ortakeve te shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk :

z. Marcello Aloisi

N.Rr.Z.P. Kavaje
Perf. nga Kujtim Katroschi

z. Massimo Carnevalli
Perf. me prokure te posacme
Nga z. Savino Roggia

Wotere
Gjyhtere

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 2433 REP.
NR. 116 KOL



VENDIM (PROCES - VERBAL) I
ASAMBLESE SE ZAKONSHME
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"KAVAJA ACQUACULTURE PRODUCTIONS"
ME INICIALE "K.A.P." Sh.p.k.,

ME QENDER NE KAVAJE, NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Sot, me date 26/09/2003, prane zyres sime te noterise me seli ne Tirane, Bul.B.Curri, jane mbledhur ortaket qe perfaqsojne te gjithë kapitalin (100%) e shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" Sh.p.k. per te diskutuar mbi rendin e dites si vijon :

1. Miratimi i Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar z. Berti Pashko, per rritjen e kapitalit te shoqerise tregtare "Kavaja Acquaculture Productions" shpk
2. Te tjera dhe eventuale

Ne vendin dhe oren e caktuar, rezultojne te pranishem ortaket qe perfaqesojne te gjithë kapitalin themeltar te shoqerise "K.A.P."shpk, d.m.th 1. z. **Marcello Aloisi**, shtetas italian, lindur me 08/07/1944 ne Sogliano, Cavour (Lecce) Itali, banues ne Itali, Modena, via girdini, nr.20/1, mbajtes i pasaportes nr. Y 028532, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine edhe te Administratorit te shoqerise "K.A.P." Sh.p.k; zoterues i 55% te kapitalit te "K.A.P."shpk 2. **Ndermarrja e Rritjes dhe Zenies se Peshkut Kavaje**, zoterues e 17,5% te kapitalit te "K.A.P."shpk perfaqesuar nga z. **Kujtim Katroshi**, shtetas shqiptar, i biri i Namirit, i dt.1954, lindur e banues ne Kavaje, me p. nr. 302866, i pajisur me dokumentin perkates si perfaqesues i N.R.Z.P.Kavaje, 3. z. **Massimo Carnevalli**, shtetas italian, lindur ne Rome, i dt. 03/05/1957, banues ne Itali, Rome, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, me pasaporte nr. 524693 T, zoterues i 27,5% te kapitalit te "K.A.P."shpk, i perfaqesuar ne kete mbledhje nga z. Elton Mezini, i biri i Sadriut, me pasaporte nr. 0484670, i pajisur me prokure te posacme.

Ne baze te Statutit kryeson mbledhjen Administratori i shoqerise "K.A.P." shpk z. Marcello Aloisi, i cili propozon per sekretar te mbledhjes z. Kujtim Katroshi. Ky i fundit pranon sa me siper.

Pas caktimit te funksioneve si me siper, Presidenti i Asamblese shpall te vlefshme mbledhjen e asamblese se ortakeve te shoqerise "Kavaja Acquaculture Productions" shpk. Pas kesaj kalohet ne diskutimin dhe vendim marrjen sipas rendit te dites.

Asambleja e ortakeve, unanimisht, per sa me siper, vendos :



1. Miratimin e Raportit të Ekspertit Kontabel të Autorizuar z. Berti Pashko, për rritjen e kapitalit të shoqërisë tregtare "Kavaja Acquaculture Productions" shpk në shumën prej 3.777.511,50 leke.
2. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë "Kavaja Acquaculture Productions" shpk të ndjeke të gjitha procedurat ligjore për reflektimin e këtij transferimi me pasoje ndryshimin e ortakerisë të shoqërisë "Kavaja Acquaculture Productions" shpk në regjistrin tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës.

Pas kësaj, meqë asambleja e ortakeve nuk ka me asgjë për të diskutuar, shtuar apo/dhe vendosur, Presidenti i mbledhjes së asamblesës së ortakeve të shoqërisë "K.A.P." shpk e deklaroi atë të mbyllur.

Ky verbal/vendim u redaktua nga unë noteria në kater kopje origjinale, në gjuhën shqipe, dhe u firmos rregullisht nga të pranishmit, në prani të perkthyeses L. Pustina.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TË SHOQËRISË
"KAVAJA ACQUACULTURE PRODUCTIONS"

Kryetari i Asamblese/Ortak
z. Marcello Aloisi
MA Aloisi 17.10.14

z. Massimo Carnevalli
Perf. me prokurë nga
Elton Mezini

Elton Mezini
EM

Sekretari/ Perf. i Ortakut NRZP Kavaje
z. Kujtim Katroski

Kujtim Katroski
Katroski

Notere

Gjilte Pustina
Gjilte

201